



KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

623-26-4363-2-1-1/C719

KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik: JAGUAR SECURITY SH.P.K.; SKYFTERAT - LIVE SH.P.K., Rr. Faik Konica p.n, Prizren, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Titulli i Kontratës: **Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit**

Me numër identifikues: 623-26-4363-2-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit**

Nr.	Grupi
1	Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i(të) detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon për një periudhë prej 24 Muajsh

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë...ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: **Në objekte të Komunës së Rahovecit**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është: **150,000.00 Euro** – [Njëqind e pesëdhjetë mijë Euro]

Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është: **plus/minus +/- 30 %**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisë do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën: Shqipe¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues:			
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Smajl Latifi
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ / Kryetari i Komunës së Rahovecit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	03.07.2026	Data:	03.07.2026
Vula:		Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve:	
Emri:	Amir Tershani
Pozita:	Pronarë
Nënshkrimi:	
Data:	03.07.2026
Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 “Shërbimet” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhën ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritset se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paafësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikën më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke i ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi


22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

623-26-4363-2-1-1/C719

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe
Fillimi dhe Përfundimi i Shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të Shërbimeve: me datën e nënshkrimit të Kontratës
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është Në Objektet e Komunës së Rahovecit
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve të përgjithshme të kontratës. Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga Zyrtar Kryesor Administrativ
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës , për kohëzgjatjen e periudhës prej: 25 Muaj , nga data e nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. b) Përgjegjësia e palës së tretë: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. d) Përgjegjësia profesionale: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik.
Parimit e përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoriteti Kontraktues për shërbimet e kryera vetëm në bazë të Kërkesave për pagese do të bëhen për shërbimet e performuara. Pagesat do të bëhen pas dorëzimit të procesit të pranimit të shërbimeve të kryera dhe faturës.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Inspektimi i shërbimeve kryhet nga Menaxheri i projektit i caktuar nga Komuna.
Pagat për punëtorët		Operatori Ekonomik duhet të i paguaj pagat dhe kontributet për punëtorët sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	20.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.



KOMPANIA E SIGURIMIT FIZIK

"JAGUAR SECURITY" SHPK

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

RR.FAIK KONICA P.N
20 000, PRIZREN
REPUBLIKA E KOSOVËS

Web: www.jaguarcom.al Email: info@jaguarcom.al

Mob: +383 48 100 150

PËR: KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

NGA: JAGUAR SECURITY SH.P.K

LËNDA: DEKLARATË

DATA: 24.06.2026

Jaguar Security Sh.p.k përmes kësaj deklarate konfirmon se do t'i përmbahet në tërësi specifikimeve teknike të detyrueshme sipas Aneksit 1 në dosjen e tenderit dhe të gjitha kushteve të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Shtojcë:

Bashkangjitur kësaj deklarate keni edhe Aneksin 1 për specifikimet teknike të detyrueshme.

JAGUAR SECURITY SH.P.K

Amir Tershani, Drejtor



Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit

PËRSHKRIMI I DETAJIZUAR

1. Tabela e objekteve

Nr.	Objektet	Orari i Punës	Numri i punëtorëve që duhet angazhuar
1	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – QKMF	24h / 7d	4
2	Komuna e Rahovecit – Objekti 1	8h / 5d Orari (08-16)	1
3	Komuna e Rahovecit – Objekti 2	8h / 5d Orari (08-16)	1
		TOTALI	6

LEGJENDA:

Viti 2026 ka gjithsejt 365 ditë kalendarike.

1. Gjatë vitit kalendarik kemi gjithsejt 104 ditë vikendi, nga të cilat 52 janë ditë e shtune dhe 52 ditë janë ditë e diel.
 2. Gjatë vitit kalendarik kemi gjithsejt 11 festa zyrtare në Republikën e Kosovës, nga të cilat kemi 12 ditë kalendarike të llogaritura si festa zyrtare sipas kalendarit shtetëror.
- Pikat 24h / 7d - nënkuptojnë të sigurohen nga 24 orë gjatë 7 ditëve të javës për 365 ditë kalendarike.
 - Pikat 8h / 5d - nënkuptojnë të sigurohen nga 8 orë gjatë 5 ditëve kalendarike për 248 ditë të orarit zyrtar (08-16) vetëm gjatë ditëve të punës (*llogohen 12 ditë festa x 24 orë + 105 ditë vikendi x 24 orë*).

SHËNIME ME RËNDËSI

Në tabelën e lartëcekur, për të rrespektuar normativën e numrit të orëve të punës prej 176 orë pune sipas Udhëzimit Administrativ MPMS Nr.09/2017 për sigurimin e të gjitha objekteve të lartëcekura sipas orarit të cekur nevojiten gjithsej 6 punëtor të sigurimit.

Operatori ekonomik i cili shpërblehet me kontratë, para nënshkrimit të kontratës duhet të sjell listën e punëtorëve të cilët do t'i angazhon në sigurimin e këtyre objekteve, AK paralajmëron se nuk do të lejoj të punësohen nga kompania e sigurimit fizik personat të cilat gëzojnë ndonjë beneficion apo pension nga skemat pensionale të shtetit siç janë: pensioner mbi 65 vjeç. Kompania nuk mund ta bëjë ndërrimin e rojeve pa e njoftuar Autoritetin Kontraktues.

Operatori ekonomik gjatë implementimit të kontratës duhet të paguajnë minimum **456.50€ pagën neto** për punëtorët që do të angazhohen sipas vendimit të ri të pagës minimale.

Autoriteti Kontraktues do të kërkoj nga operatori ekonomik i cili arrin të nënshkruaj kontratën për secilin muaj listën e pagave dhe të pagesës së kontributeve pensionale pranë ATK-së të të gjithë këtyre punëtorëve që angazhohen në këtë projekt duke verifikuar për secilin punëtor se si po paguhet nga kompania dhe a po rrespektohen kërkesat e vendosura. Të gjithë punonjësit jeni të obliguar t'i regjistroni dhe lajmëroni pranë ATK-së. Në rast se Autoriteti Kontraktues konstaton shkelje të këtyre të drejtave do të marr të gjitha masat konform ligjit dhe kontratës së lidhur ndërmjet palëve, duke bërë shkëputjen e kontratës në mënyrë të njëanshme dhe konfiskimin e sigurimit të ekzekutimit.

Poashtu kompania e sigurimit fizik pas nënshkrimit të kontratës duhet të nxjerr '*Autorizimin për nisjen fillestare të veprimtarisë*' për këtë kontratë për shërbimet themelore të sigurimit konform Ligjit Nr.04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë dhe të njëjtën të ia dorëzoj personave përgjegjës për këtë kontratë tek Autoriteti Kontraktues. Kompania poashtu duhet të rrespektoj edhe ligjin e lartëcekur gjatë implementimit të kontratës.

Nuk lejohet llogaritja e çmimit njësi dhe total me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore.

Vërejtje për OE: Punëtorët nuk duhet t'i tejkalojnë orët e punës në muaj prej 176 orë në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2017 të MPMS-së. Autoriteti kontraktues do të kërkon nga operatori ekonomik i cili nënshkruan kontratën që ti përmbahet Ligjit të Punës duke i ofruar dëshmi për çdo muaj lidhur me pagesat e kryera përfshirë shtesat, dhe në rast të mos ofrimit të dëshmive **do të rezultojnë deri në shkëputjen e kontratës** në mënyrë të njëanshme për mospërmbushje të kontratës. Operatorët ekonomik të kenë parasysh që në një pikë roje e cila sigurohet 24 orë të llogarisen se duhet zbatuari orari i punës prej 8 orë punë pra të llogariten minimum 4 roje për një pikë roje 24 orëshe sipas tabelarit të vendosur.

Në rast të ndonjë ndryshimi të pagës minimale nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës, Autoriteti Kontraktues përmes një Amandamenti në përputhshmëri me Ligjet në fuqi do të bëjë ndryshimet ligjore. Në raste kur ka ndryshime sipas një ligji, akti nënligjor apo vendimi të një organi kompetent, çmimet e kontratës do të rregullohen në përputhje me rrethanat.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

1. Kompania do të siguroj rojtar sigurie të pajisur si duhet dhe të trajnuar mirë, në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktues. Mbikqyrësi i kompanisë do të garantoj që rojet e sigurisë të kryejnë detyrën kryesore të mbrojtjes së punonjësve dhe pronave të Komunës së Rahovecit. Kompania do të siguroj të gjitha materialet dhe pajisjet e nevojshme të punës dhe të mbikqyrjes për të kryer shërbimet në të gjitha aspektet dhe garanton se të gjitha shërbimet do të kryhen me kohë dhe në mënyrë profesionale. Kompania duhet të prezantoj menaxher të certifikuar dhe të dëshmuar sipas standardeve për menaxhimin e riskut për këtë projekt, i cili do të monitoroj kualitetin e shërbimeve që ofrohen dhe të shqyrtoj dështimet apo mangësitë në ofrimin e këtyre shërbimeve të sigurisë.
Menaxheri i Projektit poashtu do të shërbej edhe si person kontraktues i kompanisë për ta zbatuar ndonjë ndryshim, modifikim apo heqje të ndonjë shërbimi që ofrohet me miratim paraprak nga zyrtarët përgjegjës në zyret e Komunës së Rahovecit në të gjitha regjionet.
2. Kompania duhet të ofrojë gjithë çka nevojitet, në përputhje me sigurinë e pa-armatosur, për të mbrojtur punonjësit e Komunës së Rahovecit, pronat e AK-së, dokumentacionin dhe mbrojtjen tjetër sipas kërkesave nga zyrtarët përgjegjës pranë Autoritetit Kontraktues. Këto shërbime përfshijnë vend-qëndrimet e sigurimit, patrullimet lëvizëse të sigurisë me përgjegjësistë në vijim:
 - Administrimi i procedurave të sigurisë në lokacionin e objekteve të AK-së,
 - Kontrollimi në hyrje të personave, automjeteve dhe pronës tjetër,
 - Vëzhgimi i lokacionit (në këmbë ose me automjet),
 - Duhet të bëhet kontrolla periodike në çdo 30 minuta në të gjitha objektet dhe pasuritë e AK-së dhe kontrollat emergjente në çdo kohë që kërkohet,
 - Identifikimi dhe raportimi i shkeljeve të sigurisë,
 - Mirëmbajtja e dosjeve që kanë të bëjnë me dokumentacionin e sigurisë,
 - Asistimi i personelit të AK-së në situata emergjente,
 - Garantimi i veprimi të shpejtë për parandalimin apo minimizimin e humbjeve nga aksidentet, zjarri, dëmtimet në pronë, rreziqet e sigurisë, shkeljet e sigurisë dhe veprimet e dyshimta, përfshirë njoftimin e punonjësve të Autoritetit Kontraktues sipas nevojës, Informimi mbi ngjarjet e veçanta që ndodhin në tërë objektin dhe pronën,
 - Rojtarët e sigurisë që punojnë duhet të paraqiten në punë me uniformat e siguruara nga kompania.
 - Uniforma do të identifikojë qartë punonjësin si roje sigurimi që punon për kompaninë, duke përfshirë kartelën e identifikimit me fotografi. Uniforma duhet të jetë e rregullt, e pastër, e hekurosur dhe të prezentojë pamje profesionale,
 - Rojtarët e sigurisë duhet të jenë të kualifikuar fizikisht që të ushtrojnë detyrat e tyre,
 - Rojtarët e sigurisë duhet të kenë njohuri elementare të gjuhëve zyrtare,
 - Rojtarët e sigurisë asnjëherë nuk duhet të braktisin objektin gjatë turnit të tyre. Rojet e sigurimit duhet të sjellin shujtat e tyre të nevojshme për të ngrënë në objekt.
 - Kompania duhet të sigurojë të gjitha uniformat, kartelat e identifikimit dhe pajisje tjera të nevojshme për kryerjen e detyrave të sigurisë.

3. Duhet të bëhet sigurim fizik i objekteve të Komunës së Rahovecit poashtu duhet të bëhet sigurimi i personelit sipas kërkesave dhe nevojave nga personi përgjegjës për menaxhimin e kontratës pranë AK-së. Operatori Ekonomik duhet të garantoj se personeli i tyre do ti kryejnë shërbimet në përputhje me përcaktimet e kontratës, në interesin më të mirë të AK-së. Në të njëjtën kohë, Operatori Ekonomik duhet të garantoj të gjitha ndërtesat, hapësirat dhe të mirat materiale të AK-së që do të jenë të sigurta dhe të mbrojtura nga vjedhja, dëmtimi, zjarri apo rreziqet tjera.
4. Roja duhet të drejtoj komunikacionin në objektet e AK-së duke evituar parkimin e veturave në vendet ku është e ndaluar parkimi i veturave, dhe të mos lejoj parkimin e veturave në vendet e ndaluara, këtu duhet të jenë në kordinim me patrullistët/punëtorët e sigurimit që do të angazhohen. Listat e automjeteve zyrtare do ti dorëzohen personelit të sigurimit fizik.
5. Kompania duhet të mbajë librat e evidencës (*regjistrimit së të dhënave të sigurisë*) për çdo automjet, person që hyn dhe del nga objektet e AK-së, OE të vendos si dokument në ofertë modelet e librave të evidencës.
6. Kompania duhet të mbikëqyrë gjithë pasurinë në të gjitha objektet e AK-së duke ndaluar çdo person që tenton të vjedhë ose keqpërdorë këtë pasuri dhe duhet t'i rrespektoj të gjitha shkresat, vendimet, udhëzimet e pranuar nga zyrtarët përgjegjës të AK-së.
7. Kompania duhet të mbikëqyrë pasurinë e AK-së dhe për çdo dëm të shkaktuar AK-së kompania që shpërblehet me kontratë është e obliguar ta kompensoj dëmin dhe nëse ngritet ndonjë kontest do të përgjigjet sipas ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës përmes një police për përgjegjësi publike apo profesionale edhe për palët e treta.
8. Kompania duhet ta rrespektoj **Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004**, të Republikës së Kosovës!
9. Rojtarët e sigurisë duhet të kenë njohuri në përdorimin e aparateve të zjarrëfikjes.
10. Menaxheri i angazhuar nga operatori duhet të ketë qasje 24 orë dhe është kompetent për vijueshmërinë e kontratës gjithmonë në kontakt me personin përgjegjës të cilin e cakton AK.
11. Kompania është e obliguar që të bëjë pagat e punëtorëve /rojeve më së largu 10 ditë pas muajit paraprak, dhe obligohet që të paguaj të gjitha kontributet pensionale.
12. Pas nënshkrimit të kontratës Operatori ekonomik duhet ta dorëzoj listën e punëtorëve që do ti aktivizoj në secilin objekt si roje.
13. Operatori Ekonomik ofertues duhet që së paku të ketë në pronësi të vet një automjet patrullues me dritë alarmuese (dritë sinjalizuese me ngjyrë të verdhë) sipas Nenit 201 të Ligjit Nr.08/L-186 dhe Nenit 6.1.7 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.10/2017.

SHËNIME TJERA:

- Operatorët ekonomik duhet t'i përmbahen në tërësi specifikave teknike të detyrueshme të kërkuara nga AK i KPK-së, për sigurimin e objekteve sipas legjislacionit në fuqi.
- Operatorët ekonomik obligohen që formularin e çmimit ta plotësojnë në mënyrë sa më të qartë dhe precize dhe me informacione të plota financiare për çdo rubrike/kolon të kërkuar me vlera të sakta financiare, në të kundërtën oferta juaj do të konsiderohet si e papërgjegjshme në qoftë se nuk ka informacion të plotë financiar do të refuzohet! Ofertës të i bashkangjitet edhe analiza financiare lidhur me kalkulimin e ofertës konform Ligjit të Punës! Ofertat të cilat nuk kanë llogaritur shtesat mbi pagën neto dhe janë nën pragun e vlerës së pagave neto, kontributeve pensionale, tatimit të mbajtur në burim, pagesave shtesë, shpenzimeve tjera, profitit e taksave do të eliminohen pa kërkuar asnjë informatë shtesë.

Çdo ofertë nën vlerën e saktë financiare të pagave dhe kontributeve tjera, shtesave etj të aplikueshme do të konsiderohet e papërgjegjshme.

Çdo ofertë e cila nuk i përmbush kushtet dhe kriteret e kërkuara në këtë dosje të tenderit do të konsiderohet e papërgjegjshme.

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është [+/- 30%] e vlerës së parashikuar.

Sigurim shtesë:

Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që të bëhet edhe sigurimi i tubimeve publike dhe ngarjeve të ndryshme të cilat parashikohen në të ardhmen mund të organizohen nga **Komuna e Rahovecit**.

Konfidencialiteti:

Punëtorët e sigurimit nuk duhet të komunikojnë me personat jozyrtar në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekte dhe nuk duhet të transmetojnë asnjë lloj informatë lidhur me punën e **KOMUNËS** pa lejen e menaxhmentit apo personit përgjegjës.

Operatori Ekonomik (kompania e sigurimit) duhet të krijoj kushtet teknike dhe kushtet tjera relevante dhe të sigurojë Autoritetin Kontraktues se përcjellja bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, respektivisht Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, **Ligji Nr.06/L-082**.

Sigurimi fizik i objekteve gjatë tërë periudhës sa do të zgjatë kontrata do të bëhet pandërprerë sipas orarit të lartëshënuar si dhe mund të ketë shtim apo reduktim të numrit të pikave dhe orëve për tu siguruar objekte tjera, kjo sipas kërkesave dhe nevojave që paraqiten nga ana e menaxhmentit apo njësive tjera të Komunës së Rahovecit.

Etika profesionale dhe sjellja

- ✓ Sjellje korrekte, neutrale dhe e paanshme ndaj qytetarëve.
- ✓ Respektim i dinjitetit dhe privatësisë së qytetarëve.
- ✓ Ndalim absolut i keqpërdorimit të pozitës apo tejkallimit të kompetencave.
- ✓ Konfidencialitet për informacionet institucionale.

Bashkëpunimi institucional

- ❖ Koordinim i vazhdueshëm me:
 - Stafin e Komunës.
 - Policinë e Kosovës.
 - Inspektoratet dhe shërbimet emergjente.
- ❖ Zbatim i udhëzimeve të brendshme.

Shërbimet duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike të parashtruara në këtë dosje të kriterëve, dhe në përputhshmëri në të gjitha aspektet të cekura si: numrin e vendrojave, punëtorët e sigurimit, dokumentacioni, mjetet dhe udhëzimet tjera.

1. Kompensimin e të ardhurave mujore (paga) në vlerë jo më të ulët se **456.50 euro neto** në muaj (në këtë vlerë duhet të shtohet: tatimi i mbajtur në burim, 5% kontributi i punëtorit dhe 5% kontributi i punëdhënësit). *Sqarim: OE, duhet të dëshmoj me një deklaratë që paga minimale për të gjithë punëtorët/menaxherët do të jetë sipas këtij kriteri (456.50€ neto) dhe kjo deklaratë duhet të jetë në dosjen e OE i cili konkurren në këtë tender.*
2. Kontraktuesi duhet të siguroi për të gjithë punëtorët e ri që punësohen pas nënshkrimit të kontratës e të cilët do të shërbejnë në objektet dhe hapësirat e **Komunës së Rahovecit**, vërtetimin nga gjykata kompetente që dëshmon që nuk janë të dënuar me vendim të formës së prerë, me më shumë se 6 muaj, si dhe certifikatat e tyre të punës për këtë shërbim.
3. Kontraktuesi duhet të sigurojë për çdo punëtorë certifikatën shëndetësore e cila garanton mbi gjendjen shëndetësore të punëtorit të angazhuar në punë.
4. Kontraktuesi duhet të sigurojë uniformën relevante për punëtorët e sigurimit, pajisjet, mbikëqyrjen, punën dhe lehtësitë e duhura për kryerjen e punëve. *Sqarim: Uniforma duhet të jetë relevante për çdo punëtorë me qëllim që të dallohet stafi nga punonjësit tjerë dhe të siguroj mbarëvajtjen sa më të mirë në punë.*
5. Kualifikimet arsimore dhe profesionale të personelit, certifikatën adekuate për sigurim fizik.
6. Për të gjitha vjedhjet e pasurisë së luajtshme të **Komunës së Rahovecit** apo dëmeve materiale dhe jo materiale të cilat janë objekt i kësaj kontrate, përgjegjësin e mbanë operatori ekonomik kontraktues, i cili është i obliguar të kompensoi vlerën e dëmit material dhe jo material ekuivalent me dëmin e shkaktuar që rrjedh nga përgjegjësia e mos kryerjes së punës nga punëtorët e sigurimit fizik.
7. Operatori ekonomik është i obliguar që të dëshmoj me dëshmi përmbushjen e specifikimeve teknike të detyrueshme Aneks 1, në të kundërtën konsiderohet **se është i papërgjegjshëm**.
8. Kontraktuesi të ketë në konsideratë së pari punësimin e punëtorëve aktual që janë duke kryer shërbimet e sigurimit fizik sipas Nenit 31 të LPP-së.



Pjesa II. LISTA E ÇMIMEVE

Përshkrimi i Çmimeve - Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia e Orëve	Çmimi për njësi pa TVSH €	TVSH 18%	Çmimi për njësi me TVSH €	Çmimi total me TVSH €
1	Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit (sipas specifikacionit teknik)	Muaj	1	€ 5,296.61	€ 953.39	€ 6,250.00	€ 6,250.00
ÇMIMI TOTAL ME TVSH Për muaj							€ 6,250.00
ÇMIMI TOTAL ME TVSH Për 24 muaj							€ 150,000.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	JAGUAR SECURITY SH.P.K.
EMRI DHE MBIEMRI I PERFAQESUESIT TE OE:	AMIR TERSHANI
NENSHKRIMI:	A.T.
DATA:	24.06.2026
VULA:	

